UDHËZIM
Nr. 421, datë 22.1.2016

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 15, DATË 24.7.2007, "PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E LËSHIMIT TË LICENCAVE, AUTORIZIMEVE DHE CERTIFIKATAVE PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË NË TRANSPORTIN RRUGOR", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës, ligjit nr. 115/2014, "Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë" dhe me qëllim rregullimin, disiplinimin dhe monitorimin e veprimtarisë së ushtruar ose që kërkohet të ushtrohet nga personat fizikë apo juridikë në fushën e transportit rrugor, si dhe integrimin e plotë të tyre në tregun evropian të transportit rrugor, ministri i Transportit dhe Infrastrukturës,

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 15, datë 24.7.2007, "Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor, të ndryshuar", bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Kudo në udhëzim, fjalët "... komunë ...", "… ose komunal …" dhe "i komunës…", shfuqizohen.

Neni 2

Në kreun IV, "Funksionimi i strukturave për dhënien e licencave/autorizimeve/certifikatave", neni 12, "Dorëzimi dhe pranimi i kërkesave", paragrafi i parë dhe i dytë, i pikës 4, ndryshojnë si vijon:

"4. Lejet e transportit (autorizimet), lejet e operimit (autorizimet) në transportin ndërkombëtar të udhëtarëve dhe mallrave dhe certifikatat e automjeteve, që shoqërojnë këto leje, nënshkruhen nga ministri ose nga personat e autorizuar prej tij.

Certifikatat e automjeteve për shërbimet e tjera të transportit, të ndryshme nga ato të përmendura në paragrafin e parë, nënshkruhen nga drejtori që mbulon veprimtarinë e transportit në DPSHTRR dhe Bashki"."

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I TRANSPORTIT
DHE INFRASTRUKTURËS
Edmond Haxhinasto